

KOMUNIKIMET

KOSOVA

NR. 1

2017

REXHAJ

Ballina: Valentina Rexhaj

LAMTUMIRË,
KOSOVË E LIRË

U FSHINË NGA TOKA
BANORËT E 779
FSHATRAVE SHQIPTARE

A JEMI POPULL
BELAXHI

A MBAHET
SHPIRTI
ME 10 CENTË

SI ME GJET BURRË
PAS AVENTURAVE
QË I PATA

VALENTINA REXHAJ

AKADEMI E MEDITIMIT,
SPIRITUALITETIT
E MOTIVIMIT





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels



**MEDITERRANEAN
LUXURY**

RELAX IN STYLE



SHERWOOD
SHERWOOD
SHERWOOD



SHERWOOD
SHERWOOD
SHERWOOD



SHERWOOD
SHERWOOD
SHERWOOD



3UE
3UE
3UE



SHERWOOD
SHERWOOD
SHERWOOD



GREENWOOD
GREENWOOD
GREENWOOD



GREENWOOD
GREENWOOD
GREENWOOD

www.sherwoodhotels.com.tr | www.greenwoodhotels.com.tr

+90 444 88 07

Valentina Rexhaj është emër i konfirmuar në fushën e meditimit, spiritualitetit, motivimit. Një grua që motivon e shëron. Valentina Rexhaj është grua-ja më e njohur shqiptare, popullariteti i së cilës ka arritur nivele të tjera, aq sa sot ajo të ketë një akademi me emrin e saj.

Akademia "VR Akademi" i ndihmon njerëzit ta transformojnë veten dhe jetën e tyre. Për konceptin, vizionin dhe misionin e akademisë, për librat e rinj që do vijjnë, e shumë të tjera, flasim me zonjën e shpresës, Valentina Rexhaj.

Valentina Rexhaj - akademi e meditimit, spiritualitetit e motivimit



“VR Akademi” tashmë ka hapur dyert, apo?

- Po, kemi pak muaj që kemi hapur akademinë për zhvillim personal dhe interesimi është tejet i madh.

Si lindi ideja për hapjen e akademisë?

- Ideja për hapjen e akademisë ka lindur nga nevoja që të jem më afër njerëzve.

Dhe, kjo nevojë, u bë edhe qëllimi im.

Para dy vjetësh kisha një staf më të vogël dhe kërkesat ishin tepër të mëdha.

Atëherë fillova të mos kem mundësi të marrë dhe trajtoj të gjithë ata që kërkonin seanca individuale.

Kërkesat ishin të shumta dhe lista e pritjes rritej çdo ditë.

Kështu, nga nevoja lindi “Valentina Rexhaj Akademi”.

Sot akademia jonë është një shtëpi e shumë anëtarëve, ku, përveç udhëtimit të përbashkët dhe zhvillimit personal, vibron një energji e lartë dhe ku secili është vetja e tij, secili e ngjyrosë jetën e vet me ngjyrat e veta.

Cili është koncepti?

- Nëse kësaj pyetje do t’i përgjigjesha me pyetje, do të ishte: Kush jemi ne?

Ne jemi trinia e shenjtë: mendja, trupi dhe shpirti. Koncepti i akademisë sonë është zhvillimi i mendjes, trupit dhe shpirtit. Secili që vjen në akademi, me mësimet, teknikat, këshillat dhe metodat, do ta gjejë fuqinë dhe potencialin e tij, e kur këto i balancoon fillon përndritja.

Vizioni dhe misioni i akademisë?

- Në seminarët dhe kurset që i organizojmë në akademi, e që kanë të bëjnë më leadership, njëra ndër mësimet është: Gjëja e vetme në leadership që nuk delegohet është vizioni i kompanisë.

Në vend të vizionit po mundem të shpalesë misionin tim në këtë akademi.

Stafi im dhe unë çdo ditë “bombardohemi” me mesazhe për

shërime që ndodhin në grupin e akademisë, shërime këto që në disa raste shkenca e mjekësisë ka hequr dorë.

Misioni ynë është që ta shtojmë këtë numër dhe ta rrisim familjen tonë çdo ditë e më shumë...

Dhe, përveç shërimeve, ne çdo ditë shohim se si zhvillohen dhe përparojnë në biznese anëtarët e akademisë.

Në fillim, kur e kam nisur këtë rrugë, jam betuar se nuk do të ndalem derisa një njeriu t’ia ndryshoj jetën.

Dhe, pa modesti, them se sot janë qindra njerëz

që më falënderojnë dhe e shijojnë jetën e sukseset e tyre.

Vizioni im është që përmes kësaj akademie të arrihen sa më shumë shërime, suksese dhe arritje personale të njerëzve, e, natyrisht, të arrihet edhe ai vizion që e kam të qartë rreth akademisë, por do ta mbaj për vete derisa të realizohet.

Pika e fortë dhe e pakrahueshme e akademisë?

- Askush nuk është si askush tjetër. Gjithçka është pjesë e gjithçkafit. Dhe, të gjithë së bashku, me këtë gjithçka, jemi vetëm një pikë, pastaj nga kjo pikë ka lindur gjithçka dhe, kështu, nga asgjë ka lindur gjithçka.

Pra, rrjedhimisht nga asgjë u bë gjithçka.

Pak e thellë, por po e thjeshtësoj. Pika më e fortë jam unë, natyrisht, bashkë me ekipin tim.

Është fat i madh që sot kemi, vërtet, shumë informacione dhe mundësi për t’i marrë ato, por rëndësia e të gjitha këtyre është se kush na i mëson dhe si na i mëson.

Pastaj, ka shumë rëndësi çfarë qëllimi ka mentori, apo mësuesi spiritual...

Si mund të bëhen njerëzit pjesë e “VR Akademi” dhe cili është programi që do ndjekin?

- Mund të vijnë në “VR Akademi”, apo të paraqiten në numrin e telefonit (Whatsaap): +41 76 232 68 69. Abonimi është tre mujor, gjashtë mujor, 1 vit.

Valentina Rexhaj, tashmë jeni shndërruar në emrin më të njohur sa i përket meditimit, motivimit e spiritualitetit. Si ishte rrugëtimi deri këtu?

- Nuk ishte kopsht me lule. Zoti ka pasur plane për mua. Jam ndër mentorët e parë, apo mësuesja e parë e meditimit në gjuhën shqipe.

Fillimisht nuk ka qenë e lehtë të flasë, sepse e kam pasur fobi të folurit në publik, e frika e fobia shtohen edhe më tepër kur temat që do të flasësh janë pothuajse të panjohura për ne si komb, si: meditimi, energjia, vibrimi e frekuencat.

Kam pasur ndjesinë që për shumë kë jam dukur si e çmendur, por bashkë me këtë ndjesi e kam ditur se duhej ta bëj, sepse ishte thirrje. Sot jam tepër falënderuese që e kam dëgjuar thirrjen e shpirtit tim. Sepse, nga ajo thirrje sot janë me mijëra njerëz që gëzojnë ndryshime nga mësimet e mia.

Unë, vërtet, e kam shijuar rrugëtimin dhe kam dhënë nga vetja maksimumin, duke mos u ndalur në zhvillimin tim.

Edhe sot vazhdoj me të njëjtin pasion mësimet dhe certifikimet tjera nga vende evropiane dhe botërore. Dhe, kur shërbejmë me dashuri e zgjidhim probleme të njerëzve, suksesi vjen vetvetiu. Suksesi është diçka e matshme, e këto matje vijnë nga rezultatet e njerëzve.

Çfarë bën që të duan, të nderojnë dhe të besojnë njerëzit shumë?

- E thjeshtë. Shumë e thjeshtë. Gjithçka që bëni mbështillen me dashuri.

Pra, kjo është formula. I dua dhe ju shërbej me shumë dashuri.

E dini cili është njëri ndër ligjet që e udhëheqë universin?

Ne marrim gjithmonë atë që japim. Suksesi dhe lumturia ime janë shumë të rëndësishme për mua, prandaj këtë ua shpërndaj edhe atyre që udhëtojmë bashkë. Sa më shumë njerëz të lumtur, bota do të jetë më e bukur për të gjithë!

Suksesi yt më i madh në jetë?

- Personi që unë jam krijuar gjatë këtij rrugëtimi.

Ju keni disa libra të botuar. Cilin e konsideroni si më të suksesshmin?

- Gjithsecili është i suksesshëm për kohën kur është krijuar. Por, mund ta veçoj librin me titull "Një fillim i ri", që është bestseller. Dhe, deri tash është libri më i shitur për zhvillim personal, i shkruar nga një autore shqiptare.

A do të kemi një libër të radhës?

- Sa më shumë që po punojmë në akademi, po e vërejmë sa larg kemi shkuar dhe sa shumë rrugë kemi përpara, e bashkë me këtë rrugë na dalin edhe gjëra tepër të bukura.

Jam duke punuar në dy perla për fëmijët. Po u them për fëmijët, ani pse librat do të jenë për të gjithë. Çdo person që do t'i lexojë, do ta terapo veten gjatë leximit të librit.

Mesazhi më i mirë që e keni marrë deri më tash?

- Kam shumë mesazhe që kam marrë dhe të gjithë janë tejet të mirë.

Por, mesazhi që më ka bërë të qaj ka qenë i një nëne që i kam ndihmuar fëmijës së saj që të mos bëjë vetëvrasje.

Ky ka qenë dhe mesazhi që më ka dhënë forcë ta vazhdoj këtë rrugëtim...

Mesazhi yt për njerëzit?

- Besoni në vete dhe në fuqinë tuaj! Kur ta kuptoni sa të fuqishëm e sa të mëdhenj jeni, sa të bekuar e sa të vlefshëm jeni, atëherë jeta juaj do të marrë tjetër kuptim!

Sidoqoftë, në fillim thashë se në të gjithë jemi pjesë e gjithçkafit, prandaj mos e tregoni veten të vogël, se ashtu nuk i shërbeni vetes dhe askujt.

Dashuroni çdo ditë, kërceni dhe shijoni çdo moment të jetës, sepse jeta është dhurata më e bukur që keni!

Nderim Nezir



U hapën dyert...

Në vitet 90 slogani ishte: “Mirë u pafshim në Kosovën e lirë!”. Madje, këtij slogani iu kushtuan edhe këngë nga Ganja dhe këngëtarë të tjerë.

E, tash, në vitin 2024, slogani do i përshtatej momentit: “Lamtumirë, Kosovë e lirë!”.

Ndryshimi ndërmjet këtyre dy sloganeve është i madh, sepse në vitet 90, ata që e lëshonin Kosovën, kryesisht nga represioni i madh policor serb dhe largimi nga vendet e punës, në mendje e kishin kthimin pas çlirimit të Kosovës.

E, tash, në vitin e sivjetmë, 2024, ata që e lëshojnë Kosovën nuk shkojnë që të kthehen, sepse represion policor në Kosovë më nuk ka, por shkojnë për kushte më të mira jetese...

Shkurt e shqip, janë në kërkim të ekzistencës, meqë pjesa dërrmuese e atyre që largohen tash janë të rinj me fakultet të kryer, e që në pamundësi që të kenë një vend pune ia mbathin “kah sytë këmbët”, siç thuhet në popull.

Sepse, edhe 24 vjet pas çlirimit të vendit, asnjë qeveri, por as e tashmja, nuk ka bërë sa duhet për hapjen e vendeve të punës për të rinjtë tanë.

E, ata që janë punësuar, kryesisht, janë punësuar në baza partiake, kurse të tjerët bredhin poshtë e lart dhe me mendjen si t'ia mbathin në Perëndim...

E, se ikja e njerëzve në Perëndim prej fillimit të vitit të sivjetmë



Lamtumirë, Kosovë e lirë!

është shumë evidente, dëshmon më së miri numri i madh i fluturimeve që bëhen çdo ditë nga Aeroporti “Adem Jashari” i Prishtinës, si dhe numri i madh i autobusëve që marrin rrugë për në shtete të ndryshme të Evropës.

U dhanë edhe shifra se rreth 400 autobusë në ditë nisen në Perëndim, edhe pse në atë shifër mund të jenë edhe vijat e rregullta që

kanë qenë edhe para liberalizimit të vizave.

E, kur do të ndalet ikja e të rinjve, por edhe të të tjerëve që shkojnë për kushte më të mira pune, kryesisht e mjekëve, motrave medicinale, punëtorëve të kualifikuar në ndërtimtari e të tjerëve, një Zot e di?!

Por, drita në fund të tunelit ende nuk po shihet...

Isa ILAZI

Ç'AMANET DO TË LËNË LIDERËT TANË?



S'di a e keni edhe ju këtë përshtypje se shpejt po ikin ditët?

Ndoshta pak vetave u duket kështu apo edhe shumicës, por, pa dyshim, ka edhe të atillë të cilëve u duket se ditët po ecin ngadalë.

Ata janë në pritje të diçkafes, janë të dëshpëruar, pa vullnet...

I kësaj kategorie të njerëzve është edhe një mik imi, i cili më thotë se e ka marrë malli për ditë të mira, ku problemet jetojnë larg. I mungon koha e fëmijërisë kur ka fjetur qetë...

Nga kjo del se nuk është e vërtetë që njeriu ndryshon me kohën. Ai ndryshon me zhgënjimet që merr nga jeta.

*

Njerëzit gati gjithmonë mendojnë mbrapsht: nxitojnë të rriten, humbin shëndetin duke vrapuar pas parasë dhe pastaj i humbin paratë për ta rikthyer shëndetin! Mendojnë me ankth të ardhmen dhe lënë pas dore të tashmen! Si përfundim, jetojnë sikur kurrë nuk do të vde-

sin dhe vdesin sikur nuk kanë jetuar kurrë.

Aleksandri i Madh para vdekjes lë amanet: "Varroseni trupin tim dhe mos më ndërtoni asnjë monument në varrin tim! M'i lini duart jashtë që njerëzit ta kuptojnë se ai që e fitoi botën vdiq duarthatë!"

A thua, ç'amanet do lënë liderët tanë, të cilët, për pushtet, harrojnë popullin?

E lënë popullin me probleme, me varfëri, me papunësi, në skamje...

Luajnë me nervat e popullit nga lakmia e tyre e madhe për pushtet!

Por, ç'mërziten ata për ne, siç thonë shumica? Ata pagat e veta i marrin me rregull, e çka u ha palla për ne?!

Krijojnë mjegull për t'u pasuruar më lehtë...

Por, pas çdo nate vjen edhe dita.

Pas çdo hidhërimi vjen edhe një buzëqeshje.

Pas çdo lutje vjen edhe një përgjigje.

E, cila është lutja jonë?

Cila është përgjigja?

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILLI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILLI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Gani Dili



Momenti historik

Familja e kryeministrit të parë shqiptar në Maqedoni të Veriut: i biri, i vëllai, bashkëshortja dhe e bija, ndjekin me përkushtim në televizor fjalën e Talat Xhaferit, me rastin e shpalljes kryeministër.

KUSH ËSHTË TALAT XHAFERI?

Talat Xhaferi u lind më 15 prill 1962, në fshatin Forinë afër Gostivarit. Shkollën fillore e kreu në Çegran, kurse shkollimin e mesëm në shkollën ushtarake në Beograd.

Studioi në Akademinë Ushtarake të Këmbëtorisë së Ushtrisë Tokësore në Beograd dhe Sarajevë.

Më vonë, gjatë karrierës së tij, u specializua në detyra komanduese në Shkup.

Me të filluar lufta në Maqedoni bëhet komandant i ushtrisë shqiptare, që luftoi për të drejtat e kombit shqiptar në Maqedoninë e atëhershme.

Ndërkaq, pas lufte u ngjiti shkallëve të politikës si zëvendësministër i mbrojtjes, e pastaj edhe ministër i mbrojtjes.

Më pastaj kryetar i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, post që e mbajti deri në emërimin e tij kryeministër.

Sidoqoftë, emërimi i tij kryeministër i Maqedonisë bëri jehonë të madhe në botën demokratike.



Pse në Cerrcë thoshin: *Bëhu si Ibrahim Rugova?*

Lideri më i pëlqyer politik i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, nuk jeton më. Por, shkrimi është bërë para vdekjes së tij, në vitin 2004 dhe shënimet janë marrë në vendlindjen e tij, në Cerrcë të Istogut.

Një kodër tërësisht e gurtë, që e rrethon nga veriperëndimi fshatin Cerrcë, ku u lind Ibrahim Ukë Rugova, ndan komunën e Istogut nga rajoni tjetër malazez.

Pleqtë e fshatit zbulojnë se Istogu ishte çerdhe e çetnikëve dhe si i tillë ende ka specifika toponimesh, si "Lugu i shkijve" etj. Cerrca, tri kilometra në jug të Istogut, është djeg, të thuash, në tërësi nga paramilitarët serbë në luftën e fundit, më 1999.

Të martën, më 9 dhjetor 2004, në fshatin Cerrcë ndërtohej rruga e fshatit për 350 shtëpi.

Më i vjetri i fshatit Cerrcë, Sadri Adem Rexhaj, i lindur më 1912, në vitin e flamurit dhe të pavarësisë shqiptare në Vlorë, njeriu që mban mend katër luftëra, kështu e nis rrëfimin:

"Kam kaluar nëpër katër luftëra, por, si kjo e fundit, e tmerrshme dhe e ndyrë, nuk mbaj mend se ka pasur.

Por, të dal te tema: Fëmijë më të mirë se Ibrahim Rugova nuk ka pasur!


Shkollë nuk kam asnjë fije, por mbaj mend shumë", thotë plaku që i mbushi 94 vjet kah mesi i vitit 2004, kur edhe u bë ky shkrim, në shtëpinë e tij, rrëzë kodrës së gurtë dhe shton:

"E kam mbërri Serbinë e parë, kohën e Shqipërisë, Luftën e Dytë Botërore dhe luftën e fundit më 1999.

Në këtë luftë kemi rënë, pikërisht, në duart e çetnikëve, në vendin e quajtur Polica, afër Rozhajës.

Na mbajtën shtatë orë në këmbë, na rrahën e torturuan me masat më çnjerëzore, por Zoti nuk kishte thënë të vdesim as kësaj here.

Nuk ka pasur asnjë luftë më të keqe se kjo. E



di edhe kur është vrrarë Ukë Rrustë Rugova, babai i Ibrahimit.

Kam qenë duke ardhur prej Istogut, kur i doli OZNA përpara, e ndaluan dhe i thanë: "Ku ishe ti?"

"Për punët e mia", u tha Uka.

E morën dhe e çuan në vendin që quhet "Lugu i xhamisë", bashkë me gjyshin e lbrës, Rrustën. Babë e birë, pas shumë torturash, i pushkatuan. Kanë vrrarë aty edhe shqiptarë të tjerë, pasi i kanë rrahur për vdekje.

Kur i kanë maltretuar, britmat e tyre janë dëgjuar te shtëpitë tona, që janë nja dy kilometra larg nga vendi ku janë bërë torturat...

Kur e kanë vra Ukën, Ibra ka qenë fare i vogël, s'di a ka pas ecur ende a jo... Nuk

kishte tjetër vëlla e as motër. Nëna e rriti jetim në kushte të vështira, por në familje të madhe dhe të ndershme.

Qysh e mbaj mend unë, fëmijë më të mirë se ai nuk ka pasur kënde", plotëson Sadri Rexhaj.

IBRA ISHTE SHEMBULL

"Unë jam shumë i vjetër, por di se shkolla i ka ecur shumë mirë. Ka qenë i dalluar për të gjitha gjërat", tregon më i vjetri i fshatit Cerrcë dhe thotë:

"Kurrë asnjë problem nuk di kush që e ka bërë si fëmijë, nuk ia di kush një të keqe sa të zitë e thoit dhe ka qenë shumë i disiplinuar. Kur i kanë qortuar prindërit fëmijët kënde,

u kanë thënë: Këqyrni Ibrahimin, pse ai nuk halitet po veç ju?!

Ka qenë, axho, shumë i tërhequr prej të gjithë fëmijëve, nuk është përzier shumë as në lojë. Gjithmonë ka mbajtur në dorë libra dhe fletore dhe ka shkruar e lexuar si fëmijë, kur të tjerët luanin lojë fëmijësh.

Këtu ka qenë zor të jetohej, se ky vend ka qenë çerdhe çetnikësh, ndërsa dy kilometra nga Istogu ka qenë një vend me emrin "Lugu i shkijve".

Tani, pas lufte, nuk është asnjë këtu, sepse e bënë punën me ikë prej këtu...

Rugovët i kanë pasur shumë në sy për të keq, por katundi i ka përkrahur fort se kanë qenë dijetarë dhe atdhetarë të mëdhenj.

Në katundin Cerrcë pat ardhur vetëm një shtëpi prej Rugove, e sot janë rreth 20 sosh. Babai im, Ademi, i pat ruajtur shumë rugovët. Ai ka pasur një rol të madh në fshat, por serbët ia sollën zullumin që ta lëshojë vendin", thotë xha Sadriu.

SA E VIZITON IBRA CERRCËN?

Duke folur për vizitat e presidentit në fshat, të afërmve dhe familjarëve, plaku Sadri Rexhaj thotë se para lufte vinte shpesh, e pas lufte, më duket, po vjen shumë rrallë.

Më tej, rreth fëmijërisë së presidentit, ai thotë: "Si familje kanë qenë të përndjekur prej serbëve. Në atë luftë e në këtë u kanë shkuar shumë meshkuj. Vetëm në luftën e fundit u kanë humbur 8-9 meshkuj, pleq e të rinj. Kanë pasur punë me të gjitha lëvizjet çlirim-tare popullore dhe kanë kontribuar shumë për popull.

Meshkujt e rugovëve i kanë vrarë në malet e Kaliqanit në Vrellë, derisa largoheshin prej shtëpive.

Janë këmbëngulës për çdo të mirë. Edhe tokën ua kanë konfiskuar shkijet dhe është shitur dorë pas dore, e askush nuk di nëse Ibra ka nisur ndonjë proces për ta kthyer tokën e konfiskuar.

Ibra nuk ka vrapuar pas pasurisë, e as sot nuk ka shtëpi të veten në fshat!

Për Ibrën di se ka qenë djalë i urtë dhe bashkë me Tahirin e Selimit kanë qenë shembuj për të mirë.

Këtu e ka kryer shollën fillore, e në Pejë normalen.

Ka pasur shumë lëvdata nga Peja e Istogu. E mbaj mend edhe kur i ka ruajtur bagëtinë, se familja është marrë me bujqësi e blegtori. Por, kurrë atë fëmijë s'e kam parë pa letër e pa laps në dorë...

U patëm gëzuar shumë kur e patën zgjedh kryetar të partisë më të madhe në Kosovë, se e ka merituar me punën e vet për popull.

Në fshat gjithmonë kemi qenë kundër shkijve, kundër Titos e të tjerëve dhe e kemi shprehur atë kundërshti gjithkund ku ka qenë e mundur.

Fshati ka qenë me idenë e Selman Kadrisë, që këndohet në këngë kur e vret vojvodën Milic

Kërstën, për çka çetnikët iu vërsulën fshatit dhe vranë shumë shqiptarë", thotë Sadri Adem Rexhaj.

PSE NUK PO BËHESH SI IBRAHIMI?

Për fëmijërinë e Ibrahim Rugovës në fshatin Cerrcë, ka folur edhe 64-vjeçari, Ali Ymer Maxharraj.

Ai thotë:

"Ibra është lindur në dhjetor të vitit 1944, nga nënë Sofa dhe babë Uka.

Kah 15 janari i vitit 1945 partizanë-çetnikët e kanë vrarë babanë e tij, Ukën, si dhe gjyshin, Rrustën.

Mbeti gjashtë javësh dhe, çka ishte më keq, kërcënohej të mbetej edhe pa nënë, se tradita e kërkonte që nusen e re ta merrnin familja e vet, por Sofa këmbënguli ta ruante Ibrën e vogël dhe ashtu ndodhi...

Nëna e rriti në shtëpinë e Azemit (vëllai i gjyshit të tij). Ishte shtëpi bujare, e pasur dhe me shumë meshkuj.

U rritë jetim, por i dalluar, shumë i dalluar", thotë Ymeri në shtëpinë e tij, derisa drejton gishtin kah trarët e djegur të shtëpisë, si e vetmja shenjë nga gërmadhat e dhunës serbe dhe vazhdon:

"Hapat e parë i bëri duke i ruajtur bagëtinë.

Oysh si nxënës i shkollës kishte prirje për mësim.

Më kujtohet, atëherë, vjersha e tij e parë "Oj nanë, oj hanë", vjershë shumë e pëlqyer.

Ibra ishte shumë i interesuar për libra e letërsi. Ishte i veçantë, kishte bibliotekë në shtëpi dhe kur i çonte bagëtinë në kullotë, në një dorë mbante librin e në dorën tjetër shkopin, ndërsa bukën kallamboqe në anshik. Kishte shumë moshatarë barinj dhe lojërat e barinjve Ibra fare pak i merrte si të vetat. Sepse, kur barinjët loznin, ai lexonte romane dhe libra historikë.

Kishte raste që edhe rrugës për në shkollë deri në Istog lexonte, sepse ishin tre kilometra largësi.

Ka qenë shumë i dalluar, i urtë, e spak problematik. Ka qenë i dobët nga shëndeti.

Kur moshatarët e tij hanin dajak prej baballarëve dhe familjarëve të vet, Ibrën e merrnin gjithnjë shembull dhe u thoshin fëmijëve:

Pse nuk po bëhemi si Brahimi të mirë?! Ka qenë shumë i dalluar dhe human.

E, se ka qenë human tregon edhe ky rast: Në vitin 1956 babai im, Aliu, shiti qetë e

shtëpisë dhe me para shkoi para shkolle, ku po ndërtohej ajo.

Dhe, pas një ndeje i bie kuleta në tokë, të cilën e kishte gjetur Ibrahim Rugova. Mbaj mend kur ai ia sollti babait të gjitha, pa i munguar asgjë", sqaron Ymeri.

IBRA I PËRNGJANTE "LULIT TË VOCËRR"

Një grumbull fëmijësh loznin në një livadh të Lagjes "Maxharraj", karshi shtëpisë së Ymerit,

përfshirë edhe Besën e vogël, e që mezi ecte. Ata pranojnë se e duan shumë Ibrahim Rugovën, njeriun që në vendlindjen e tij e adhuron i madh e i vogël, me ndonjë përjashtim. "Besë, ti kë do?", e pyesin djelmoshat që loznin.

Ajo ua kthen: "Lugovën!".

Në Lagjen "Rexhaj", Albani, Diamanti dhe Arben Rexhaj, që të gjithë në klasën e shtatë, sikur edhe Albioni në të dytën dhe Shpresim Rexhaj në të gjashtë, thonë:

"Mos kërkoni këtu fëmijë që s'e duan Ibrahim Rugovën, se nuk ka të tillë! Ne jemi të gjithë me të dhe jo pse është yni, por pse është i mirë!

Na kanë treguar prindërit tanë se ka qenë gjithmonë më i miri dhe është munduar për Kosovën".

Sidoqoftë, Cerrca, fshat rural i komunës së Istogut, frymon lirshëm me shtëpitë e reja, të ndërtuara pas lufte, pasi të vjetrat janë djegur tërësisht.

Megjithatë, xhaxhai i Ibrahim Rugovës, Ali Rugova (1927), tregon si kanë qenë shtëpia e madhe prej 42 anëtarësh në familje deri në vitin 1953.

"Pesë meshkuj të vijës së Ballit Kombëtar na kanë rënë për lirinë e Kosovës. Dhe, ne, pas vrasjes së tyre, kemi pasur shumë probleme me regjimin serb", thotë Aliu, i cili ka qenë kujdestari i parë shtëpiak i Ibrës, pas vrasjes së Ukës dhe Rrustës nga OZNA në Kullën e Popit në Istog, të udhëhequr nga çetniku Dushan Popoviçi.

Aliu dëshmon se për shkak të konflikteve me OZN-ën, kishte probleme ta dërgonte në shkollë Ibrahimin jetim.

Por, ekzistonte edhe një gjendje e padefinuar mes familjes për ta dërguar në shkollë. Nëna i thoshte se nëse e dërgonte në shkollë do ta paguante me kokë.

Por, familja ishte ndërtuar mbi themelet e sakrificës dhe të viktimizimit për atdheun.

Dhe, në rrethana të tilla morale dhe intelektuale, pavarësisht pasojave, Ibrahim Rugova u dërgua në shkollë, si i vetmi djalë i Ukës dhe nënës që e rriste jetim, e që e kishte refuzuar kthimin te familja e vet, për ta rritur djalin - Ibrahimin.

Dhe, duke plotësuar detajet e fëmijërisë së nipit të tij, Aliu thotë:

"Ibrahimi verës shkonte në Rugovë, në Bjeshtë e Leçinatit. Shkonte më shumë për të mësuar. Ka qenë nxënës i mirë dhe i befasonte të gjithë.

Kur shkova në shkollën normale në Istog, t'i vizitoja djemtë - Rrustën dhe Ibrahimin, drejtori, Abdurrahim Gashi, më tha se Ibra do të përmendet në Kosovë.

Ai pat aq shumë komplimente për të sa më befasoni edhe më shumë kur më tha se prej tij pritet diçka e madhe, sepse ishte shumë i veçantë.

E kam përcjellë edhe në Pejë si nxënës dhe ia rregulova banesën. Vetëm edukata fizike nuk i shkonte. Në një rast, profesori Riza Bici, më tha se nuk e kishte kuptuar hartimin e



Ibrës, meqë idetë e tij shtriheshin mbi një semantikë të gjerë kuptimësie. Dhe, ashtu siç thoshin për të profesorët në shkollë, dilte se fjala ishte për një profet, e jo për një njeri. Sidoqoftë, e kam shkolluar kryesisht unë, me kushte të vështira”, thotë Aliu.

IBRA NUK BLINTE PANTALLONA, POR LIBRA

Duke folur se sa ka qenë Ibra i mishëruar me librin, Aliu tregon se çdo metelik që binte në dorën e tij, ai e shpenzonte për libra.

“Për një maj i dhashë para që të shkonte në Pejë dhe të blinte pantallona e këpucë. Por, Ibra kishte shkuar në shitore dhe kishte blerë pantallona shumë të lirë dhe paratë tjera i kishte harxhuar duke blerë libra.

I bërtita pak, por ai nuk reagoi, se librat i donte shumë...

Në sallën e kinemasë në Istog aso kohe u mbajt një kuiz, ku merrnin pjesë në planin e letërsisë Ibrahimisi dhe një malazez. Malazezin, që pati përkrahje të madhe dhe simpati nga rrethi komunal dhe i intelektualëve të kohës, e që ishin të lidhur me politikën dhe zhvillimet, Ibra e mposhti me dijeni, e unë pata kritika pse nuk e kisha veshur mirë, pasi Ibra, në vend të këpucëve kishte mbathje llastiku, “jemenia”.

Por, pasi ua shpjegova se paratë i kishte harxhuar për libra, ata të komunës ia dhanë 5000 dinarë. Paratë i dhanë në shenjë fitoreje mbi malazezin në kuizin e letërsisë. Dhe, thënë të drejtën, bazuar në kohën e rëndë sociale që ishte, nuk e kam lënë të heqë, edhe pse nuk kisha nga të merrja të ardhura.

E, ato pak para që i merrja i ndaja për të tre: Ibrën, Rrustën dhe Kumrien.

Ibra ka qenë i kujdesshëm edhe si student, por ka qenë tepër i vendosur dhe me qëndrime të forta.

Kur u martua Rrusta, i thashë se para tij në plan martesë ishte Ibra. Por, Ibra më tha se nuk i interesonte as fejesa e as martesë, por vetëm libri.

Në shtëpi ka qenë shumë i matur. Nuk mbaj mend se ai më ka pritur ndonjëherë ulur. Gjithnjë ngrihej në këmbë për më të vjetrin, e për mua të mos flasim, kishte shumë respekt dhe maturi”, thotë Aliu.

Biblioteka e xha Aliut, ku ai thotë të jetë

furnizuar me libra Ibra, është djegur në luftën e fundit, sikur edhe fshati Cerrcë, në brendinë e të cilit janë atakuar e marrë në polici shumë veprimtarë pas viteve të nëntëdhjeta, kur u themelua LDK-ja.

E VËRTETA PËR SHALLIN

Enveri, djali i Aliut, duke komentuar funksionin e shallit të Ibrahim Rugovës, shpalos se, të thuash, të gjithë rugovasis e Cerrcës lëngojnë nga fyti, ose janë të ndjeshëm në fyti. “Jo, nuk ka asnjë rol tjetër e as domethënie tjetër bartja e shallit nga Ibra, pos që ne, rugovasis, e ruajmë fytin.

Thashethemet tjera për bartjen e shallit të tij janë spekulime”, thotë Enveri.

SI E KUJTON IBRAHIM RUGOVËN BASHKËVENDËSI ISË REXHAJ?

Në shtëpinë e tij, të ripërtëritur pranë të vjetrës së djegur, Isë Rexhaj (1930), me bashkëshorten Hylën (1947), me profesion mësuese, në ditën që i vizitua, e rikujtonin fshatin në kohën kur Ibrahimisi ishte fëmijë.

“Për Ibrën vetëm libri ka qenë veçanti dhe ai e ka tërhequr”, thotë ai, i bindur se Ibra nuk dallohej shumë prej fëmijëve të tjerë dhe vazhdon:

“Nuk ishte as ndër më të dalluarit në veshje, as ndër më të varfrit. Ishte mesatar...

Ka qenë shumë i qetë dhe kjo veçori e ka përcjellë gjithmonë, për aq sa ne e njohim në fshat.

Im axhë e kishte provokuar Ibrën në kuptimin pozitiv, por nuk e kundërshtonte në asnjë mënyrë, sepse ishte shumë i rezervuar.

“Ty me pas mundësi të kisha bërë ballanxhi (pilot), se për kohën ishte profesion i paarritshëm për shqiptarët”, i kishte thënë Ibrës me një rast xha Beka.

E mbaj mend teksa shkonte në shkollë. Ecte, zakonisht, anës së rrugës. Ishte shumë i sjellshëm, me shumë probleme sociale. Më përngjante, disi, në “Lulin e Vocërr” të Migjenit.

Dhe, i tillë më rri në kujtesë gjithmonë Ibra... Ibrahimisi i ruante bagëtinë edhe në “Bjeshkët e Thata” dhe te “Gurrat e Bardha”, në stanet e Rugovës.

Kurrë s’e mban mend kush që ai të jetë fjalosur me ndokënd”, thotë Isa.

E, bashkëshortja e tij, Hyla, ndërhyr duke thënë se Ibra kurrë nuk ka qenë vetjak.

“Na mbante në orë letrare, deshëm a s’deshëm. I thoshim, po shkojmë se jemi uritur, e na thoshte se edhe ai ndjente uri, por ora letrare ishte më e rëndësishme.

Kur ai shkoi në Prishtinë, disi doli në harresë nga fshati. Ishte koha e tillë dhe dinamika e shpërndarjes së njerëzve fliste me gjuhën e vet se gjërat ndryshonin shumë.

Për herë të parë Ibra bëri bum kur u zgjodh kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës.

Ne, si fshat, u desh të organizohemi ta mbrojmë dhe mbështesim autoritetin e tij, përballë nacionalistëve serbë, të cilët mundoheshin me strategjinë e dinakërisë së tyre ta degradonin personalitetin e tij në ardhje dhe formim e sipër.

Çetnikët serbë mundoheshin ta kontestonin publikisht karakterin e Ibrahim Rugovës, për t’u larguar prej tij shqiptarët, ndërsa për konsum të brendshëm politik ata e shfaqnin Ibrën si njeri të rrezikshëm për Serbinë.

Ne e përkrahëm dhe demantuam qëndrimin e Serbisë, që kishte për qëllim zhvishjen e Ibrahim Rugovës nga kombëtarja.

Për ne, fshatin, befasia më e madhe ishte kur ai u zgjidh kryetar i LDK-së, si lëvizje politike, për t’i rezistuar me strategji fitimtare okupatorit tonë klasik dhe radikal.

Ibra gëzonte besim të plotë te ne dhe kurrë nuk jemi ndalur te e kaluara e tij, ashtu siç nuk ndalej as ai vetë.

Ne, duke e njohur nga vegjelia, vendosëm të shkojmë pas tij në rrugën e lirisë dhe ajo erdhi...

E kishim njeri të besueshëm të popullit.

Në fshat kishte serbë që tentonin ta topitnin tehun e aksionit të tij politik, menjëherë pas themelimit të lëvizjes, LDK-së.

Serbët e dinin kush kishte qenë babai i Ibrës, se si ishin vrarë Uka dhe baba i Ukës, Rrustemi.

Ne, duke qenë përballë serbëve, përkrahëm LDK-në që ishte lëvizja më e madhe në gjithë ish-Jugosllavinë që po dezintegrohej”, thotë ajo.

Sidoqoftë, Isë Rexhaj ishte marrë në pyetje në polici tri herë dhe qëllimi ishte të kuptonin nëse Ibrahim Rugova e kishte marrë detyrën e tillë me motiv të hakmarrjes së babait dhe gjyshit të tij të vrarë nga forcat serbe.

Një polic, me emrin Millajçiq, e që njihej në Istog si njeri i përgatitur ideologjikisht, pasi shtroi pyetje për Ibrën, tha:

“Jo, Ibrahimisi është i mençur, nuk e merr vetë atë detyrë, por për qëllime lufte dhe të organizimeve të tilla e ka Fehmi Aganin”.

Pra, kishte edhe provokime të ngjashme në policinë e regjimit serb, e cila na merrte në biseda informative, për të zbuluar qëllimin e Ibrahim Rugovës”, tha Isa.

Në anën tjetër, Enver Ali Rugova, thotë:

“Ibrahim Rugova nuk ka qenë në fshat që nga viti 1990 dhe shkaku dihet. Por, thotë se nuk kishte kohë të vinte...

Thotë, gjithashtu, se nëse vinte shpesh do të na shkaktonte reperkusion të dhunës politike, që do ua shkaktonin serbët.

Ibrahim Rugova ka premtuar se do të vjen këtë vit, për ta përruar asfaltin rrugor në fshat”.

Safet Krivaça



U fshinë nga toka banorët e 779 fshatrave shqiptare!

Gjatë historisë shqiptarët, si populli më i vjetër në Ballkan, kanë humbur Sanxhakun e Nishit me rreth 779 fshatra, e që dihen me emra në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1877 dhe 1878.

Megjithatë, në atë kohë e sot fshatrat e Sanxhakut të Nishit mbajnë emra shqip: Katun, Kastrat, Gërgur, Zhush, Paqaradë, Konjufcë e të

tjerë, e për të cilët edhe serbët që jetojnë atje thonë se ishin fshatra shqiptare.

Por, politikat e gjenocidit të Serbisë mbi shqiptarët e Sanxhakut të Nishit nuk ndodhën aty për aty, por atyre u parapriu një politikë shfarosëse serbe, e mbështetur nga Evropa e atëhershme.

Dhe, popullit shqiptar të Sanxhakut të Nishit nuk i mbeti tjetër pos të ikë në atë dimër të ftohtët të vitit 1878 nga trojet e veta dhe të vendosën si muhaxhirë në Kosovën e sotme dhe në Turqi.

Sidoqoftë, letrat e këtij gjenocidi nuk i ka hapur kurrë as Turqia, edhe pse ajo ishte pronare e vetme

sunduese në atë kohë në këtë rajon dhe më gjerë.

Andaj, tash, kur po faktorizohen shqiptarët në rajonin të Ballkanit, rendi është që kryeministri i Kosovës Albin Kurti dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në koordinim me Turqinë, ta shpalojnë arkivin e Stambollit dhe të kërkojnë nga Serbia përgjegjësi për gjenocidin e atyre viteve ndaj 779 fshatrave shqiptare të Sanxhakut të Nishit.

Sepse, faktet ekzistojnë, fshatrat ekzistojnë, të dhënat e historia-nëve serbë ekzistojnë, shënimet janë...

Safet Krivaça



NGRIT STILIN E JETESËS TUAJ!



CIMA RESIDENCE
LAGJJA E MUHAXHERËVE

+383 49 50 90 90 | www.cimaks.com

Flash



Sinan Vllasaliu pa afat skadimi

Këngëtari i zemrave, Sinan Vllasaliu, vazhdon të mbetet në krye të listës së më të preferuarve.

Kanë dalë shumë emra të rinj në skenë, mirëpo Sinanit assesi nuk i është bërë konkurrencë.

Me pamje, me zë, me burri... ky

është këngëtari që e duan dhe e pëlqejnë të gjithë. Në paraqitjen e fundit, me rastin e festës së Vitit të Ri, në Televizionin "Dukagjini", në emisionin "Sonte s'ka fajron", edhe një herë dha përshtypjen se këngëtari i hitit "Shkaktar" është "pa afat skadimi".



Gazetarja Alketa Gashi-Fazliu lexon shumë

Gazetarja e njohur, Alketa Gashi-Fazliu, është nga Prizreni. Fillimet në fushën e gazetarisë i ka nisur në "Radio Prizren", kur ishte e re.

Por, qe sa e sa vjet është në RTK, në cilësinë e moderatores dhe e prezanton me kënaqësi emisionin e mëngjesit në "Radiotelevizionin e Kosovës".

Alketa është edhe shkrimtare – poete.

Shumë herë ka thënë se gjithmonë e ka pasur në shpirt shkrimin, madje ka botuar qysh në fëmijëri të hershme.

Megjithatë, pasioni i saj i vërtetë është leximi.

Lexon shumë...

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android



ANDROID APP ON
Google play

Si me gjjet burrë pas aventurave që i pata?

Jam mbi 30 vjeçe. Nuk kam qenë e rehatshme deri para një kohe, sepse u jam lyer atyre që kishin vetura të mira, që të shëtisnin sa në Kosovë e sa në Shqipëri...

Jam nga fshati. Jam ngopur nga aventurat. Më nuk më dilet as në qytet, e lëre më të shkoj në Shqipëri, siç bëja më parë, sa herë që më tekej.

Kurrë familja ime nuk ka dëshiruar të martohem me një djalë fshati, sepse në djemtë e tillë ata kanë parë gjendjen skamnore, si e kishim edhe ne, ani pse mendoj se mu të tillët janë të ndershëm, dinë ta respektojnë femrën, gruan.

Andaj, pavarësisht se çka mendojnë familja dhe të afërmit e mi, e vetmja gjë që më intereson për burrin tim të ardhshëm është sinqeriteti.

E ardhmja është me interes për mua. Sepse, qëllimi im i vetëm tash për tash është ta njoh një burrë për të krijuar familje: të bëhem nënë dhe t'i

edukojë fëmijët si duhet, meqë koha e aventurave të mia ka kaluar dhe jam ngopur me dashuri rruge...

SI U MBUSHA MEND?

Më duket se tash jam në gjendje qysh në komunikimin e parë me një mashkull të dalloj sinqeritetin apo jo sinqeritetin e tij.

Nuk mund të rrijë as edhe një minutë të vetëm me njeriun që gënjen, që aktron e trillon.

Kam arritur ta kuptoj se meshkujt e sodit më shumë janë të dhënë pas interesit se si me e shti përfundi një femër sesa si me krijuar të ardhme me të!

E, sot askujt nuk i marrë lakmi për pasuri, meqë e kam vërejtur pasuria

nuk është gjithçka, nuk ta garanton lumturinë.

Por, do i merrja lakmi moshatares sime, e cila martohet me njeriun që e meriton...

Në anën tjetër, nuk mund ta paramendoj jetën bashkë me një mashkull, të cilit, sa herë që do më puth, para syve do i shfaqen të dashurat e shumta që i ka pasur!

S'DUA MË MASHKULL PËR ARGËTIM!

E them edhe një herë: Nuk dua të njoh më asnjë mashkull për argëtim, por mashkull me të cilin do krijoja familje. Dhe, deri kur ta gjej një të tillë, do të jetoj kush si po jetoj tash: e vetme.

E., Pejë

Në odë të "babës"...



Disa politikanë mendojnë se gjithmonë janë për pushtet!

Kishte hipur një njeri mbi degë lisi dhe po e prenë degën ku qëndronte ai vetë.

Kalon aty pari Nastradin Hoxha dhe, posa e pa se po e prenë degën ku ai qëndronte vetë, i tha:

"O njeri, do rrëzohesh se po e prenë degën ku ti rri vetë!"

Druprerësi i tha:

"Shiko ti punën tënde! A nuk ke me çka tjetër të merresh, por me mua, a?!"

Nastradini vazhdoi rrugën, kurse ai bie nga lisi posa e prenë degën...

Kur ra në tokë tha se kalimtari paska qenë profet dhe i sulet pas.

Kur e arriti, i tha:

"Ti qenke profet! Më trego kur do të vdes?"

"Nuk di kur do të vdesësh!"

Ai nuk e lëshonte Nastradinin të ecte tutje pa i treguar...

Dhe, kur Nastradini pa se ai nuk do e

lëshojë dot, i tha:

"Ti do të vdesësh kur të rrëzohet tërë lisi!"

"E, si po e di?!", e pyeti.

"Sepse, ai të shtypë dot!"

Andaj, edhe pushtetarët tanë janë të tillë. Nuk dinë se po rrëzohen edhe kur e humbin pushtetin.

Të tillët mendojnë se ende mund të del ndonjë gjë, helbete...

S. M.



Skicë

Si jetohet sot në Grashticë?

Fshatrat e Gallapit gjatë luftës janë përfshirë nga masakrat më të tmerrshme që njih historia e njëzimit. Për 500 të vrarë, siç thuhet në Grashticë, nuk është ngritur asnjë aktakuzë në Hagë e askund gjetiu!

Andaj, edhe sot në Gallap jetohet me plagët e vitit 1999, e jeta vazhdon me hallet e përditshme...

Kështu, disa lagje edhe janë boshatisur tërësisht, si, bie fjala, Lagjja e Sherifovitëve. Por, ka edhe lagje që janë rregulluar edhe më mirë se që kanë qenë para lufte.

A mbahet shpirti me ?

Derisa pi kafe në një restorant në rrugën “Vellusha” në Prishtinë, vjen një grua bukur në moshë, shtrin dorën dhe kërkon 10 centë...

“10 centë! Ju lutem, vetëm 10!”
I kisha dy euro nga një. Ia jap njëren.
Dhe, pasi më falënderon vazhdon tutje...
“10 centë, ju lutem, vetëm 10!”, refren ky i përhershëm...
Nuk di nga është lypësja, por e shoh shpesh në kafene të ndryshme të Prishtinës.
Ndoshta është nga Llapi, sepse ashtu më duket e folmja e saj...

NGA VENDI QË MIGJENI MORI TBC-në...

Ndërkohë, vjen edhe një femër tjetër me fëmijë në krahë. Nga pamja shihet qartë se është nga Shqipëria, nga atje ku Migjeni mori TBC-në nga refrenet e tillë. Kërkon para, por nuk shoh se i jep kush...
Pas pak vjen një lypsar kosovar, por me stil ndryshe. Shpeshherë të njëjtin e shoh edhe në semaforë dhe, teksa u lypë para femrave shofere, kur ndonjëra ulë xhamin për t’i dhënë ndonjë cent, ia prek edhe flokët!
Afrohet afër meje dhe sikur më njeh që moti, më prek me gishta në faqe dhe më thotë:
“M’i jep 50 centë, menjëherë!”
Dhe, dikush i jep para nga frika, dikush nga mëshira...
“Ja, merri dhe shko!”, i thotë njëra.

Kryesisht, nga frika i japin para femrat, sidomos vajzat e reja, sepse ai di edhe t’i maltretojë: i prekë në trup, në faqe, në flokë...

Ky është lypësi më modern i Prishtinës. E ka gjetur mënyrën si të fitojë, sidomos nga vajzat e reja...

Keq, them me vete, derisa pi makiato 3-4 lypës të sillen përreth dhe s’ke si të pish kafe rahat...

U KA ARDHUR GAZEPI NË MAJE TË HUNDËS!

Por, ndalem dhe mendohem: Njeriu nuk e shtrinë dorën bash kollaj, pa pasur ndonjë gazep...

Nuk e shtrinë dorën pa i ardhur shpirti në maje të hundës...

Mirëpo, edhe a mbahet shpirti me 10 centë?!

I.I.

Pse jemi dhënë “me mish e shpirt” në celularë?!

*Ju kujtohet nëma
“Folsh me gishta!”?
Kjo nëmë i ka tejkalu-
ar normat e “mall-
kimit”, sepse ne tani
as me gishta nuk po
flasim, meqë gishtat
na janë ngjitur për
celular!*

Kushdo që i përdorë rrjetet sociale, e njeh këtë fenomen, kur, në realitet, nuk ke hiq kohë, por do shpejt ta dërgosh një sms apo ta hapësh një e-mail dhe magjia virtuale veç ka ndezur shkëndijat e para në ty dhe vazhdon me një foto, një video, një story, hajt veç edhe një....

Dhe, papritmas, i trishtuar, kupton se plotësisht ke harruar kohën, e për arsyen se çka deshe në telefon s’bëhet fjalë!

ÇKA SHKAKTOJNË MEDIET SOCIALE?

Askush nuk beson se çfarë na shkaktojnë mediet sociale dhe konsumimi i tyre!

Ne mendojmë se të varur janë të

tjerët, e jo unë! Me fjalë të tjera, “ferri janë të tjerët!”.

Pas çdo varësie të ne fshihet një boshllëk, të cilin ne, në rrjetet (anti) sociale çdo ditë e më shumë po e stimulojmë lirin e dopaminës nëpërmjet reagimeve të menjëher-shme që marrim e që në trurin tonë regjistrohen si shpërblim.

Mirëpo, reagimi dhe konfirmimi social, si në jetën reale, e, po ashtu, edhe në botën virtuale, nuk është gjithmonë konstant, si çdo gjë tjetër në jetën tonë.

Ky irritim të ne zgjon mëdyshje dhe pasiguri, ku ne fillojmë krahasimin e vazhdueshëm të vetes me njerëzit tjerë dhe kjo mund të ketë pasoja

jashtëzakonisht negative për shëndetin tonë mendor, veçanërisht për të rinjtë.

SHQETËSUES ËSHTË DEFORMIMI I REALITETIT

Por, edhe më shqetësues është deformimi i realitetit tonë nëpërmjet emisioneve të famshme televizive, të cilat paraqesin një “jetë reale” të njerëzve, të cilët na bëjnë të ditur gjatë tërë kohës se është vetëm lojë. Një lojë goxha e mirë, pasi që neve, shumicës, na e ka marrë zemrën, duke harruar realitetin tonë dhe jetën që konsumohet me çdo minutë të humbur para ekraneve televizive, duke përjetuar realitete që nuk ekzistojnë, pos për të vjedhur kureshtjen dhe energjinë tonë! Unë, personalisht, kur thellohem në formate të tilla (edhe pse si profesioniste për vetëdijen kolektive mund të mësosh shumë për shoqërinë tonë në to, madje falas), më bie ndërmend fakti se në qoftë se nuk paguan për një produkt, mos harro, atëherë ti je vetë produkti!

Shkëndije Pacolli



PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges

Shkëndije Pacolli



BOOM



Lori
"Krejt dashni"

Lori “Krejt dashni”

Lori është ylli i padiskutueshëm i skenës muzikore shqiptare, e cila sapo i ka dhënë dritën e gjelbër EP-ës së saj me titull “Krejt dashni”, që në përbërje ka këto këngë: “A nuk o dam”, “Ti ma ke lanë”, “Me aeroplan”, “A kisha ditë”, “Kush me na nalë”, “Di di dikush” (në duet me Yll Demajn).



LORI GODET ME GJASHTË HITE

Këngëtarja që njihet për transformimet e jashtëzakonshme në stil dhe muzikë, edhe një herë kthen sytë kah vetja.

“Krejt dashni” është një EP me gjashtë këngë të shoqëruara me videoklipe, e të punuara me shumë delikatesë nga një ekip profesional, në krye me ikonën e krijimit të muzikës unike, Aida Barakun.

Lori, që shkëlqen në interpretim dhe pamje, në lansimin e këtij projekti ka falënderuar me shumë emocione Aidën.

“Faleminderit Aida ime, për çdo notë dhe varg që shkruajte për mua me dashuri e përkushtim, të kuruar në çdo detaj! Pa dyshim, pa dorën e artë të mikut tim, Armendit, nuk mund ta përmblyllim kaq bukur këtë projekt.

Faleminderit për gjithë kontributin që keni dhënë të dy gjatë gjithë karrierës sime, në formimin tim si artiste!

Shumë nga hitet, perlat dhe arritjet e mia ndër vite mbajnë vulën tuaj.

Me fat që ju kam!”.

LORI EDHE NJË HERË DËSHMOI SE ËSHTË E PAKRAHASUESHME

Në këtë projekt muzikor, me gjashtë këngë hite, Lori edhe një herë dëshmoi se është yll i pakrahasueshëm në këndim dhe paraqitje.

Këngët e reja të Lorit tashmë po dëgjohen gjithandej...

Nderim Neziri



VIP-at shqiptarë që zgjedhën borën a plazhin...

Artisët e estradës shpeshherë verën e shfrytëzojnë për punë, koncerte e këngë dhe kjo gjë i bënë që në dimër të gjejnë kohë për veten. Disa prej tyre këto ditë kanë zgjedhur borën, e disa të tjerë plazhin...



BORA DHE DONALDI

Çifti më i komentuar i medieve rozë, Bora dhe Donaldi, këtë vit kanë vendosur që për ditëlindjen e Borës pushimet t'i kalojnë në borë, duke skijuar në një vend turistik.

Sigurisht, dyshes iu shtua edhe Arbori dhe Romeo, të cilët kanë shijuar dhe kanë ndarë shumë momente të bukura bashkë.

KIDA

Kida ka zgjedhur Dubain, destinacion për pushime të saj.

Si duket, ky vend po e shijon këngëtarën, teksa ka postuar imazhe të ndryshme me poza tërheqëse.

Pushimin Kida po e kalon me miq të afërt.





DAFINA ZEQRIRI

Pas një angazhimi tejet të suksesshëm, Dafina dhe i dashuri i saj zgjedhën t'i kalonin pushimet në Maldive.

Çifti më i ri i shou-bizit po e shijojnë diellin bashkë.

Mbase ky pushim ishte i merituar pas bujës së madhe që mori albumi më ri i Dafina Zeqirit.

NORA ISTREFI DHE ROBERT BERISHA

Nora dhe Roberti u ribashkuan për një pushim të shkurtër me vajzën e tyre.

Si duket, skijimi ishte pikësynimi i tyre dhe i Renes.

Megjithëse nuk kanë postuar asnjë portret familjar, Nora dhe Roberti në rrjete sociale kanë ndarë foto me vajzën.



ARBENITA ISMAJLI

Viti i sivjetmë nuk filloi aspak lehtë për Arbenitën. E, për t'u qetësuar shpirtërisht dhe fizikisht zgjodhi Dubain, si destinacion perfekt. Modelen e ka shoqëruar motra dhe vajza e saj.

Arbenita ka ndarë me ndjekësit çdo vend që ka vizituar dhe duket se pushimin familjar e ka shijuar mirë.

Denisa Oruçi

Këngëtares tona që arritën të perfeksionohen

Më nuk janë siç ishin dikur, në fillimet e karrierës së tyre. Ato kanë ndryshuar shumë, e kjo ka ndodhur falë ndërhyrjeve estetike, transformimit të stilit etj.



BIG MAMA

Publiku e pranoi lehtë e shpejtë, pasi ajo ishte më ndryshe dhe nuk ngjante në mostrat që ishin të pranishme në industrinë e muzikës në vend.

Ndonëse dukej interesante me përmasat "XL" dhe me stilin e saj ngjyra-ngjyra, Big Mama gjatë gjithë kohës ishte nën presionin e idesë së të qenit ashtu siç ishte, nuk ishte "perfekt".

Sidoqoftë, i dimë përpjekjet e Big Mamës për të ndryshuar... Dhe, ia doli me sukses të plotë...

DAFINA ZEQRIRI

Rrugë e gjatë për ta kapur suksesin. E gjatë dhe me sakrificë. Por, këngëtarja ia doli me këmbëngulje, madje edhe me një varg investimesh në pamjen e jashtme, duke filluar nga hunda, mollëzat, buzët, gjinjtë...

Dafina e dikurshme me të tashmen, si nata me ditë!



NORA ISTREFI

Ishte e bukur edhe si 17-vjeçare, kur edhe u shfaqë për herë të parë në skenë.

E, e bukur është edhe tani. Por, ishte ndryshe atëherë e ndryshe tani.

Nora Istrefi u konsiderua "seks bombë", por iu nënshtrua një regjimi të rreptë për heqjen e kilogramëve...

E tash, e bukur si Nora më!

Bukuri e rrallë

Është prezantuesja më e njohur dhe më e përfolur në Kosovë. Çdo paraqitje e saj publike kthehet në lajm, duke u bërë kështu një nga personazhet më të përfolur në vend. Është ndër të paktat femra të shou-bizit pa operacione plastike dhe që sërish duket bukur dhe, pa dyshim, sensuale dhe joshëse.

Liberta Spahiu, moderatorja e emisionit "Prive", shpesh ironizon, madje ka raste kur merret edhe me veten në mënyrë ironike, çka shkakton reagime interesante të adhuruesit e bukurrosjes.

Por, kjo është Liberta, krejt e paparashikueshme...

As nuk më merr për grua, as nuk më lë!

Jam në hall të madh. I dashuri im sikur do t'më hakmerret për një tradhti të vogël që ia kam bërë vite më parë. Tash as nuk më merr e as nuk më lë!

Me të dashurin tim jam njohur në muajin qershor. Ishte koha kur edhe pak ditë dhe e përfundoja shkollimin e mesëm në Prizren.

Thënë të drejtën, si vajzë nga fshati, isha paksa e strukur, sepse shoqet e mia nga qyteti dinin dredhi, dinin të kënaqeshin, dinin të argëtoheshin.

E, çka jo tjetër?!

Por, deshi fati dhe në atë kohë, si nga qielli, piku një djalosh 5 vjeç më i vjetër se unë dhe nisi t'më vardisej.

E, ajo vardisje bëri që unë të përfundoj në krahët e tij... Dhe, verën pas maturës sime e kaluam bashkë.

Mirëpo, kur erdhi tetori i atij viti, unë veç isha studente në njërin nga fakultetet e Universitetit të Prizrenit dhe kjo më bëri edhe më shumë të lumtur...

Por, që në ditët e para fillova të hamendesa, kur njëri nga studentët e grupi nisi

t'më vardisej dhe mendja nisi t'më turbullohej, ani pse lidhja me të dashurin tim sa vinte e bëhej më e mirë.

SI E ZBULOI I DASHURI IM TRADHTINË TIME?

Një ditë, pas ligjëratave, frajleri nga grupi im i fakultetit, këmbënguli që të dilnim në shëti bashkë.

Dhe, hap pas hapi u gjendem në "Marash", restorant kryesisht i të rinjve në periferi të Prizrenit, afër kalasë, pranë lumit që vinte nga malet e Sharrit.

E, kur u ulëm jashtë të merrnim kafe, në një tavolinë në qosh të oborrit, ishte ai... i dashuri im, e që posa më pa, shpejt u ngrit dhe ka ardhur te ne.

Më përshëndeti, por u përmbajt. Nuk shkretoi ndonjë fjalë të rëndë. Më tha: "Vetëm desha të të përshëndes!".

Dhe, u kthye te shokët e tij...

Por, të nesërmen, kur u takuam, krisi kiameti: nuk la gjë pa më thënë.

E, unë, meqë isha me faj, nuk flisja. E, kjo e nevríkoste edhe më shumë.

SI HUMBI MIRËKUPTIMI?

Sidoqoftë, prej asaj dite më nuk kemi pasur mirëkuptim, edhe pse ishim dhe jemi bashkë qe tre vjet rresht.

Por, kur i them të fejohe mi a të martohem i, ai heshtë dhe nuk më thotë as po e as jo.

Kjo më jep me kuptuar se është mllëfosur në mua dhe don t'më hakmerret...

Megjithatë, kam ardhur në përfundim: As nuk dëshiron t'më lë, por as nuk më merr!

E, kjo mua po më pengon, sepse jam duke e humbur kohën kot me të, e rinia ime po shkon, bukuria ime po vyshket...

Meli, Prizren



Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco
vaten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444

Pse vetëm këngëtares e bukura kanë albume?

Disa këngëtares janë modeste dhe nuk janë të imponuara për të bërë emër. Këngët e tyre frymojnë me shpirtin e tyre, ashtu siç janë edhe në jetë, origjinale...

S., edhe pse e shtyrë në moshë, ende zonjushë, me fakultet të kryer, e sheh të vështirë depërtimin në atë që quhet estradë pa u ofruar te produksionet dhe individët, së pari fizikisht, më pas me

gjërat dhe vlerat tjera, çka ajo e vlerëson si tejkallim të njerëzores.

SFIDAT E VËSHTIRA TË JETËS...

E ka nisur karrierën e këngës qysh në shkollën fillore dhe është krenare që e ka pasur fatin t'i përballojë sfidës së kohës, që të mos ndalet në fillim të rrugës, fat të cilin e përjetuan shumë bashkëmoshatare të saj, e që e ndalën këngën shkaku i pengesave në familje.

Sepse, aso kohe, shumë vajza shkonin në koncerte pa dijen e familjes...

Prandaj, nuk mund të flasë për sukseset pa i përmendur dhe shumë vajza të tjera, që vinin tinëz familjes në ushtrime, e kjo e brengoste gjithnjë.

Veçmas e pengonte fakti se çdo gjë bëhej nën maskën e interesit...

Andaj, është vështirë të depërtosh nëse nuk ua plotëson kushtet produksioneve dhe njerëzve që merren me punët organizative...

Sepse, nëse nuk je e bukur dhe nëse nuk i ke disa elemente që t'i përmbushësh kërkesat e tyre, zor me pas këngë, albume apo prezantim në programet festive të fundvitit.

ÇDO KËNGË E KA FINANCIUAR VETË...

Ajo mburret me faktin se çdo këngë të incizuar, çdo videoklip e ka paguar me para të veta, e jo me sponsorë, siç bëjnë shumica e këngëtareve tona...

S. M.



Saint **Valentine**

STARTING AT 230 €/COUPLE

Ali Pashë Tepelena 74 vjeç, mori grua Vasiliqen 18 vjeç!

Dashuria nuk njih moshë, as ligje dhe kriterë. E, një ndër to njihet dashuria e Ali Pashë Tepelenës me Vasiliqen.

Vasiliqia Kontakciu njihet si femra më e bukur dhe më besnike shqiptare. Ajo i qëndroi besnike e përgjeshme Ali Pashë Tepelenës, ndonëse moshat e tyre kishin dallime gjashtëdhjetë vjet!

Ali Pashë Tepelena ishte 74 vjeç kur njohu Vasiliqen 14 vjeçe, ndërsa u martuan pas katër vjetësh...

KUSH ISHTE ILAÇI I TEPELENËS PËR JETË TË SHËNDËTSHME?

Vasiliqia e bukur, thjesht, u bë ilaçi i Ali Pashë Tepelenës dhe e mbajti gjallë me forcën madhështore prej sundimtari.

Dhe, përkundër burrërisë së rëndë të Ali Pashë Tepelenës dhe moshës së tij 74 vjeç, lidhja e tyre mbijetoi deri te krijimi i këngëve që këndoheshin atëherë, por këndohen edhe sot, si kënga "24 pashallarë".

Andaj, ajo që është më rëndësi në këtë storje të martesës së Ali Pashës në këtë moshë, të gjithë historiografët që janë marrë me këtë rrëfim historik, e kanë pasur më shumë temë Vasiliqien sesa Ali Pashë Tepelenën.

E, pse ndodhi kjo?

Portreti i Vasiliqies ka tërhequr vëmendjen e analistëve, jo vetëm për bukuri, por edhe për një virtut tepër të shenjtë njerëzor, me të cilën

krenohemi ne, shqiptarët, e ajo është besa dhe besnikëria e gruas ndaj burrit.

Vasiliqia ishte një femër e bukur që bëri karrierë mençurie, duke qenë në një pozicion tepër të vështirë:

Një, në mes Janinës dhe, dy, në mes Portës së Lartë të Stambollit.

SI U TAKUA VASILIQIA ME ALI PASHË TEPELENËN?

Një takim mahnitës e kishte befasuar Ali Pashën, në moshë të shtyrë, kur ai, rastësisht, mbeti i magjepsur me bukuroshen që kurrë më parë nuk e kishte parë dhe kjo ishte Vasiliqie Kontakciu.

Takimi ndodhi në mesin e logut të ballafaqimit të ushtarëve të pashait dhe manipuluesve të parave që po i falsifikonin ato në fshatin Plishivicë.

Cenimi i dinjitetit të Ali Pashë Tepelenës, që e qeveriste rajonin, e shpuri atë në ofensivë kundër falsifikatorëve dhe, pikërisht, në mesin e urryeriu shfaqë vajza katërmëdhjetë vjeçare, Vasiliqia, e cila kërkoi shpëtim nga pashai.

Pashai i vuri zjarrin fshatit, por Vasiliqia, me bukurinë mahnitëse, kërkoi mbrojtjen e sulmuesit, e sulmuesi ishte vetë Ali Pashë Tepelena.

"Ne nuk meritojmë sundimin e Pashait të tmerrshëm dhe as mërinë e tij! Na mbro, të lutem!", ishin fjalët e saj.

Pashait iu fut turbullira në kokë, e ngriti në këmbë vajzën e re dhe, pasi e shtrëngoi në gjoks, i tha:

"Mund të jeni drejtuar gabimisht, sepse pikërisht unë jam veziri i keq dhe i urryer, që i vura flakën fshatit!"

Por, ajo këmbënguli që pashai ta mbronte...

Dhe, kur pashai pa këmbëngulësinë e saj, ia dha

besën se do ta mbronte dhe se ajo do të ishte pjesë e pallatit të tij mbretëror.

E, kur Vasiliqia u bë tetëmbëdhjetë vjeçe, ajo bëhet sekretarja e parë e Rezidencës së Tepelenës. Dhe, në prill të vitit 1816 martohet me pashain.

Nga dashuria dhe respekti për të, Tepelena i ofroi Vasiliqies edhe mundësinë ta ndërronte fenë...

"Jo, sepse një grua që heqë dorë nga perëndia e saj, nuk mund të jetë besnike e një perëndie tjetër!"; i thotë ajo.

Sipas njohësve të jetës sekrete, thuhej se Vasiliqia ishte ilaçi i Ali Pashës, e që i shërbente atij edhe për shëndet të mirë dhe të ndihëj i fuqishëm në zgjidhjen e problemeve...

SI E DËRGUIAN TURQIT VASILIQIEN NË STAMBOLL?

Mirëpo, erdhi dita kur Pashë Janina u tradhtua dhe pësoi tragjedi.

Dhe, me të përfunduar jeta e Pashait, komanda turke urdhëroi që Vasiliqia të depërtohej në Stamboll.

Por, jeta e saj u kursye së ekzekutuari, kryesisht për shkak të bukurisë mahnitëse.

Në Stamboll Vasiliqia i ra në gjuhë të parit të portës, jo për ta kursyer nga vdekja, por për të mos e turpëruar, meqë sytë e komandantëve ishin të mbushur me kureshtje që ta kishin pranë vetes...

Ajo në atë kohë ishte 22 vjeçe, në zenitin e bukurisë...

E kërkuan shumë mbretër e burrështetas për grua, por Vasiliqia nuk pranoi të martohej, sepse me vdekjen e Pashë Tepelenës për të kishin vdekur të gjitha gëzimet e jetës dhe si ngushëllim do t'i mjaftonte kuptimi për burrin që e kishte pasur...

Kur e tradhtova burrin u ndjeva se ende jetoj!

Kur ta lexoni këtë shkrim ndoshta edhe do t'më urreni, por mua do t'më vinte shumë mirë sikur qoftë edhe një lexues ta kuptonte gjendjen time dhe të mos mendonte keq për mua. Kam një sekret të madh brenda vetes, të cilin vendosa ta ndaj me shumë njerëz, duke ruajtur anonimat. Kam bërë mëkat, por në emër të dashurisë...

Po shkoj drejt të dyzetave dhe jam rritur në frymën e historive të dashurisë të romaneve që lexoja kur isha e re. I përpija ato histori me shpejtësi skëterre dhe më pas ëndërroja se si do të ishte jeta ime, si do të ishte njeriu që do ta kisha në krahë, si do të ishte marrëdhënia jonë. Kisha krijuar shumë ide, shumica e të cilave qenë të gabuara, gjë që e kuptova kur hapa sytë dhe pashë që jeta e vërtetë ishte ndryshe.

SI FILLOVA TË KEM "PUNË" ME SHOKUN E BURRIT?

U martova me një njeri të mrekullueshëm, me të cilin çdo gjë shkonte qetësisht. Mbështeteshim dhe e respektonim njëri-tjetrin, por asnjëherë nuk i përjetova ato skenat e fuqishme të dashurisë si nëpër faqet e librave. Unë ëndërroja që dikush t'më merrte me forcë, t'më rrëmbente, të bënte dashuri me mua për net të tëra.

Nisa të jetoja monotoninë e jetës, duke e pranuar si një pjesë normale të jetës së gjithsecilit.

Gjithçka që tashmë doja ishte një fëmijë. Por, me burrin, pavarësisht se kishim marrëdhënie, unë nuk mbetsha dot shtatzënë. Unë ia veja fajin natyrës së mar-

rëdhënies sonë.

Ne bënim dashuri si me buton, sikur na detyronte njeri dhe jo sikur e donim me të vërtetë këtë gjë.

Dhe, pavarësisht nga gjendja që po kaloja, asnjëherë nuk e kam menduar se do ta tradhtoja tim burrë. Pavarësisht se mbetsha një femër shumë pasionante, e dija që tashmë jeta ime kishte marrë një drejtim të caktuar dhe nuk mund të bëja gabime të tilla, por Zoti gjeti, pikërisht, atë kohë për të më bërë dhuratë dashurinë e jetës sime.

Arsimi ishte shoku i burrit tim. E di çfarë po mendoni, që është diçka e pështirë ajo që do t'u tregoj, por, në fakt, e di se ju kurrë nuk do ta kuptoni dot atë që ndieja unë në ato momente.

Unë doja të ndihesha femër e dashuruar, ndaj dhe vendosa t'i pranoja përkujdesjet e Arsimit, të cilat në fillim ishin miqësore dhe më pas nisën të kishin natyrë sentimentale.

KUR E TRADHTOVA BURRIN U NDJEVA SE ENDE JETOJ...

Me rastin e një feste të organizuar, në një skutë të fshehur midis një morie njerëzish, u konsumua marrëdhënia jonë e parë. Ishte e fuqishme, e plotë, shpërthyes.

Asnjëherë nuk isha ndërjer ashtu. U ndjeva femër, u ndjeva e re, u ndjeva sërish plot jetë dhe besim.

Pa dyshim, pasuan edhe shumë takime të tjera...

Sigurisht, e dija se ishte një gjendje që nuk do të mund të shkonte asgjëkundi, por, nga ana tjetër, ndihesha mirë, e dëshiruar, nuk doja që kjo lidhje të mbaronte.

Ndërkohë, marrëdhëniet e mia me tim burrë vazhdonin, por ishin më të rralla. Më dukej si një njeri i panjohur në krevat, ndërkohë që në jetën tonë të përditshme ai vazhdonte të ishte bashkëshorti im.

Por, e gjithë situata u përmbysë kur mora vesh se kisha mbetur shtatzënë. U lumturova, fluturoja mbi re nga gëzimi, sa për një moment harrova të mendoja se kush mund të ishte babai i foshnjës.

Aty e kuptova që kishte ardhur momenti për ta zgjidhur gjithë situatën në të cilën ndodhesha.

Pas një muaji frike, im burrë më tha se shoku i tij, Arsimi, ishte larguar jashtë vendit përgjithnjë dhe që më bënte të fala pasi nuk kishte pasur mundësi për t'më takuar.

U lehtësova. Pikërisht në atë moment i thashë burrit se isha shtatzënë...

Rema

A jemi popull belaxhi?



Nuk ka ditë e të mos vritet dikush prej dikujt! Nuk ka ditë të mos theret ndokush! Nuk ka ditë të mos rrahjet ndokush me ndokënd!

Rrahjet dhe vrasjet në Kosovë janë bërë si buka e djathi, demek nuk të kënaqë shumë buka po nuk pate djathë. E mbaj mend xha Ajetin kur isha fëmijë. I kishte shumë djem dhe çdo ditë i sillnin nga një bela në shtëpi. Kur bënin bela të lehta, shembull, kur kishin rrahje, nuk kishte nevojë t'i tregonin fare, sepse nuk i llogariste si gjëra të rënda, kurse kur ndodhnin plagosjet thoshte: "Për hajër koftë!". "O mixha Jetë", i thoshin: "Djemtë tu janë plagu. A nite a jo?". "Për hajër koftë çka koftë!", përgjigjej ai. Edhe neve, po na lusin me u pajtua me Serbinë dhe mendoj me vete se çka do të bëjmë, ore burrë, nëse pajtohemi? Do të shuhet një bela e madhe, një front i luftës e i biznesit. E, kur është fronti i hapur, punon tregtia e zezë, punon shverci e kontrabanda... Krejt këto në emër të patriotizmit, siç thoshte i ndjeri Baftiu, në konferencat e fshatit. Mbanim mbledhje për asfaltimin e rrugës gjashtë kilometra në fshatin tim të lindjes. Flisnin burra e burra...

"Ju doni me bë asfalt, jam kah e di, por mendoni se ende problemet me Serbinë nuk janë zgjidhur!", thoshte Baftiu. E, pas fjalëve të tij ndërroi tërë muhabeti në lokalet e shkollës së fshatit... Dhe, lëre më që nuk mbaronim punë rreth asfaltit, por përhapej në popull se do të kriste lufta së shpejti e nuk ishte reni i asfaltit...

KUSHA IM FLET VETËM PËR RRAHJE!

Kusha im punon taksist. Besa, kohëve të fundit as që po punon, se e ka kapluar sëmundja. Por, tërë kohën kur ka punuar e ka qar kohën duke u rrahur me taksistë të tjerë. Qysh tregon edhe vetë, cilido që ia ka prishur rendin, i ka dhënë dajak. Ia bëra kështu një burri... e rraha një tjetër... ja theva kokën atij... shkuam në polici dhe u thashë kështu e ashtu... Kështu, pra, i ka shkuar jeta kushës tim, sepse rrahjen e ka ushqim të shpirtit. Bukën mund ta lë, ama grushtin jo! E, shqiptari, edhe kur e ngritë dorën për të stopuar ndonjë automjet, posa ta ngritë dorën, ia dhuron një sharje: "Ndale bre, nënën ta lujsha!". Njëri prej intelektualëve, që po e kursej të mos ia përmendi emrin se e njehë i madh e i vogël, e le telefonin mbi tavolinë dhe vetë hyn në banjë. Ndërkohë, telefoni cingëron. I thotë menaxherit: "Shih, bre, kush është!". "Qenka Izeti", ia kthen menaxheri. "Uh, bre, ku më gjeti bash tash ai bërllok!

Hape telefonin dhe rreje diçka! Thuaj se jam diku... Kudo qoftë!", i flet nga banja. Dhe, pasi menaxheri ia thotë Izetit fjalët e intelektualit, ai e kupton se po e gënjen. Izeti pyet në sportel të hotelit se në cilën dhomë ndodhet ai, demek intelektualin... Dhe, ia mësynë dhomës së intelektualit... Pasi troket në derë, një njeri e hapë derën. Izeti i thotë se ishte ai që e kërkoi pak më parë në telefon intelektualin... Burri afrohet te banja dhe i thotë se erdhi ai që të kërkoi pak më parë në telefon. E, kur intelektualin e hapë derën e banjës dhe e sheh Izetin, i bërtet menaxherit: "Pse nuk më the se ishte Izeti, jarani jem! Mendova se është Izeti i Preshevës e atë nuk e kam në huj hiç, bre mahluk!" dhe i afrohet menaxherit t'ia ngrehë veshin... Por, ai, intelektualin, siç e kishte zakon të rrejë, rrenën nuk mund ta largonte nga vetja. Një ditë vjen nga Zvicra një mik i tij dhe e thërret në telefon. I thotë se ka ardhur nga Zvicra dhe dëshiron ta takojë... E, ai i përgjigjet me një qeshje të gjatë... "Po, mirë që paske ardhur në Kosovë, por unë jam në Tiranë. Besa edhe gruaja nuk është në shtëpi. Ka tri ditë që është në Stamboll. Unë kthehem nesër nga Tirana, kurse gruaja pas një jave dhe shihemi", i thotë intelektualin. Por, nipi, i cili ndodhej afër gjyshit dhe e kishte dëgjuar bisedën e zhvilluar, i thotë: "Gjysh, pse e rrejte që nuk je në shtëpi?!". "Shuaj! Pasha gjyshin ti s'e di pse duhet me rrejtur! Je ende i ri e mendon që nuk duhesh gënjyer, por kur të bëhesh sa gjyshi mësohesh edhe ti", ia kthen ai.

Sokol Murturi



ALLURE BEAUTY JU KTHEN
20 VITE
pas në kohë!



Pa dhimbje! Pa kirurgji!
Allure Beauty

Si ka qenë puthja e parë e baballarëve tanë?

Si ka qenë dashuria e parë?

Si ka qenë puthja e parë?

Në këto pyetje përgjigjen të moshuarit: E. Vitia., nga Ferizaj dhe T. Musa., nga Klina.

SI KA QENË NJOHJA E PARË?

"Jam njohur me Eminen në kohën kur isha në shkollë të mesme në Ferizaj. Më pëlqente pamja e saj, trupi i saj, flokët e saj, mënyra si fliste, si qeshte... Dhe, çka jo tjetër?! Por, s'kisha guxim t'i afrohesha. Kisha një droje se do më thoshte: "Shko! Ikël!"

Mirëpo, me kohë filluam të afroheshim... Me kohë filluam të komunikim, të prekeshim...

Me kohë erdhi edhe puthja e parë... Por, isha i ri dhe nuk kam ditur ta shijoja atë puthje, sepse emocionet udhëhiqnin me mua e jo unë me emocionet! E, po t'më ndodhte sot, në të 70-at që jam, do të ishte krejt ndryshe", thotë E. Vitia., nga Ferizaj, 70 vjeç.

SI KA QENË PUTHJA E PARË?

"Puthjen e parë e kam pas menduar krejt ndryshe, e doli krejt ndryshe! Pse? Sepse, mendoja se me puthjen e parë do të jemi gjithmonë bashkë, por nuk ndodhi ashtu. Nja një vit isha bashkë me Lulen, nga një fshat afër Klinës, me të cilën ishim bashkë në një klasë. Por, pas nja 2-3 muaj bashkë u hidhërua në mua se më pa me një vendase timen

nga Gjurakovci, fshat afër Klinës. U mundova ta bindja se e kisha vetëm vendase dhe asgjë më shumë, po nuk më besoi, apo gjeti një arsye të largohet nga unë, e këtë se kam kuptuar as atëherë e se di as tash, kur ma mundësuar ta kujtoj atë ngjarje të asaj kohe shumë të largët, sepse unë tash jam 72 vjeç, e ajo ngjarje ishte moti", thotë T. Musa, me banim në Klinë.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

Secili brez i ka historitë e veta të jetës. Por, brezi i tashëm ndryshon shumë nga ai i baballarëve të tyre, e të mos flasim i kohës së gjyshërve të tyre. Tash të rinjtë tanë nuk i kushtojnë shumë rëndësi as dashurisë së parë, as takimit të parë, as puthjes së parë. Madje, ka të tillë që nuk i kushtojnë rëndësi as martesës, sepse, thonë, nuk paskemi qenë për njëri-tjetrin! E, habitshme, a?

Diturie Haxhaj

Nëpër një fushë kalonte rruga e vetme e asaj nate. Po asaj rruge erdhi nëna. U ndjeva tepër i lumtur. Kur desha ta përqafoja, e ndjeva veten se ende isha fëmijë dhe asgjë më shumë.

Por, iku nëna me mjegullën e dendur dhe e gjithë lumturia u shndërrua në një mashtrim të shpirtit...

Atë ditë do të thërriste një vajzë e re në telefon dhe do bënim një takim gjysmë pune, në të cilin do të kishte gjithçka nga pak.

Kisha planifikuar një ditë të mirë argëtimi. Por, mendja më shkonte se do të ndodhte diçka që do ma prishte lumturinë...

Ishte bërë gati mesditë kur telefoni hodhi "flakë". Nuk ishte thirrje si të tjerat, por ishte e zjarrtë!

Nuk zgjati as dhjetë minuta dhe thirrja tjetër flakëroi monitorin e telefonit tim. Do të vinte edhe një tjetër për çështje krejtësisht pune.

Në atë moment i thashë kolegut tim se isha i pafat. Njëra thirrje e prishi tjetrën dhe i refuzova takimet e ditës, meqë nuk do më linin rehat thirrjet të pija kafënë e ditës.

ËNDRRA E LUMTURISË SË RREME...

Duke se ia kishte dhënë ferku i mëngjesit kur edhe më kaploi dëshpërimi. Ishte një gjysmë kllapie gjumi dhe po mendoja pse më ishte shfaqur ëndrra e lumturisë së rreme...

E kisha pritur një vit atë ditë dhe isha i dështuar. Djersët në ballë vazhdonin të binin në çarçafin e bardhë të shtratit. Në fakt, ishte një arsye që më kishte gënjyer atë natë lumturia.

Ngrita kokën sikur doja të testoja shëndetin se a do mund ta ngritja kokën apo jo...

Ngrita kokën dhe pash unazën time afër kokës, pak e fshehur nën jastëk. Nuk mbaj mend ta kisha hequr nga gishti.

Nuk është unazë fati, nuk është as unazë



Pse e rrejë veten se jam i lumtur?

lumturie. Nuk është as unazë zemre. Është unazë dyngjyrëshe: bardhë e zi. Ashtu sikur realiteti i kësaj nate - prisja të gëzohesha dhe u dëshpërova!

Por, dikush që e ka frikë natën e ka një shpresë, që do të thotë se do agojë mëngjesi, do agojë dita dhe dielli do e tretë frikën, sikur vesën mbi barë.

JETA E KA TË BARDHEN DHE TË ZEZËN

Unazën do e barti çdo ditë tani e tuje. Ajo thotë se 24 orëshi e ka ditën dhe natën. Të bardhën dhe të zezën.

Kur të jesh i pikëlluar dhe nuk sheh tjetër pos fundit të botës, shfaqet pika e bardhë, që thotë se pas kësaj vjen diçka e bukur...

Jeta është e përditshme dhe hidhërimi e gëzimi janë pjesë e përditshmërisë së zemrës.

I kisha menduar të gjitha këto, teksa duhej t'më kishte zënë gjumi përsëri...

Dhe, kur isha sërish në gjumë, nëna ecte drejt meje. Më shtrëngoi e më përqafoi shumë. Më puthi në faqe si dikur dhe nisi të largohej nga unë.

Unë u mbusha jetë nga përqaftimi i saj... Zgjata duart ta ndalja.

I thashë më prit se dua të vij me ty.

Ajo më tha: "Tash je bërë burrë dhe mund të jetosh edhe vetëm..."

E, në çast, shpejt ngrihem nga shtrati dhe ulem duke buzëqeshur. Lotët e kanë qullur çarçafin e bardhë...

S.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A kanë magji fëmijët e mi?

Përshëndetje zonjë, jam nënë e tre fëmijëve. Kam pasur probleme me vajzën e madhe. Pat kontakte me një të huaj, por nuk e donim. Dhe, pak para se të martohesha, na ndihmove dhe ajo u nda prej tij...

Por, tash e kemi një problem të ri: Djali i madh më herët ka qenë i sëmurë nga magjia. Ai thotë se halla i ka bërë magji.

Që nga ai moment frika është përcjellë edhe te vajza, e cila ikë prej hallës së vet...

Në anën tjetër, të gjithë dyshojmë se ajo merret me këtë punë...

A është e vërtetë apo jemi gabim?

“Nëna me halle”

Përgjigje:

Sipas asaj që shoh unë, djali ka pasur një problem të natyrës psikiatrike, që ka qenë pasojë e frikës dhe ai e ka gjuajtur gurin te dikush, sa për ta arsyetuar veten dhe,

pastaj, këtë problem e ka ndërlidhur me hallën.

Por, kjo nuk është e vërtetë.

Ti, a do i bëje keq djalit të vëlait tënd?

Me siguri, jo, sepse bijat mezi presin ta shohin mirë familjen, ku janë lindur e rritur...

Është keq kur ja ngarkoni dikujt problemin personal dhe familjar, diçka që te mentaliteti ynë ndodh me të madhe, prandaj unë ua them me shumë bindje të mos frikësoheni nga halla dhe ta doni, sepse nuk ka asgjë të vërtetë prej asaj pune.

Gruaja më është bërë e dyshimtë!

Përshëndetje! Kam shumë respekt për ju.

Jam nga Prizreni. Kam avokaturën time.

E kam një fëmijë që rritet me nënën e vet, me të cilën jemi ndarë, sepse kisha dyshimin se më tradhtonte, edhe pse isha besnik ndaj saj.

A më ka tradhtuar gruaja

dhe a do të ribashkohem me të?

“Pa shifër”

Përgjigje:

Nuk shoh se ka pasur tradhti nga gruaja jote. Ka qenë shumë korrekte. Në fakt, sjelljet e saj i ke përcjellë vetë... Si avokat që je, e di shumë mirë se dyshimi nuk është vërtetësi.

Pra, nuk të ka tradhtuar gruaja, por të ka tradhtuar karakteri yt!

A do të martohem gjatë vitit 2024?

Zonja magjistare, jam vajzë, 18-vjeçare. Jam në lidhje që tri vjet me një djalë nga qyteti im. Familja ime ka kuptuar vonë për ne dhe nuk e ka mirëpritur lajmin mirë.

Dhe, që nga ajo kohë ai është ftohur prej meje...

A do të martohemi sivjet apo do të përfundojë lidhja jonë?

“E brengosura”

Përgjigje:

Në vitin 2024 ju do të keni fejesë. Konkretisht, gjatë muajit prill do të fejoheni dhe në gusht do të martoheni.

Familja, pa marrë parasysh si kanë dashur të jetë fati yt, do të pajtohen me vendimin tënd për t'u martuar.

Fati i vonuar

Jam 43-vjeçare. E kam kryer fakultetin që shumë vjet. Kam punuar gjashtë vjet

dhe më kanë larguar nga puna për arsye se nuk bëhesha kukull e shefit.

Megjithatë, kam mbetur edhe pa fatin e jetës...

Deri para dy vjetësh e kam pritur një person, me të cilin doja ta lidhja jetën, por plani im dështoi.

E, tash, meqë koha ime ka ikur sa i përket fatit, të lutem, çka më pret në jetë dhe a do kem fat të kem edhe unë njeriun tim?

“Pa shifër”

Përgjigje:

Ti ke pritur njeriun që qe martuar kaherë, prandaj ky ishte gabimi yt jetik, sepse i ke humbur kot rreth 13 vjet për atë person!

Sidoqoftë, e shkuara nuk kthehet...

E, çka tash?

Nga parashikimi im për ty del se dy oferta do t'i kesh brenda gjashtë muajsh dhe e dyta do të jetë më e përshtatshme për ty.

Të dy ofertat do të jenë në afërsi kohore, por rasti i dytë do të jetë për ty më i miri.

Mos e refuzo!

A ishte reja me probleme edhe pa ardhur te ne?

Përhëndetje, jam zonjë, 58-vjeçare, sapo kam martuar djalin e vetëm që kam, por nuk jam e kënaqur me renë!

Djali po e përkrahë dhe nuk po i bën presion që ajo të ndryshojë.

Thotë se ka kohë për t'u

përmirësuar.

Ajo vetëm na shikon dhe bëhet sikur do të na thotë diçka, por nuk po e qel gojën!

Jemi të dyshimtë se ka magji...

Nuk e dimë nëse ka qenë kështu gjithmonë, apo i kanë bërë diçka prej kur ka ardhur te ne...

Me askënd nuk jemi keq dhe as që kemi qenë ndonjë herë, prandaj jemi në hall të madh se çka të bëjmë me nusen...

Çka na sugjeron?

“Nëna e brengosur”

Përgjigje:

Nuk është puna as te magjia, e as te fakti se ka pasur magji më parë. Por, nusja do të ndahet nga ju, prindërit e djalit, dhe të jetojë vetëm me djalin. Këtë këshillë ajo e merr nga familja dhe, kështu, edhe i ka pasur premtimet nga djali juaj te familja e saj.

Nëse ju doni ta bëni të lumtur djalin tuaj, që të jetojë me të, atëherë lërinë të jetojnë ata dy vetëm, sado që kjo për juve është e dhimbshme.

Por, do të zgjidhet problemi që e keni me renë...

Megjithatë, nuk i shoh në perspektivë të gjatë pa probleme...

Jetoj me dhimbjet e përditshme...

Jam nënë e dy fëmijëve, 17 dhe 19 vjeç. Jetoj jashtë Kosovës.

Jetoj me një shqetësim të

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

përditshëm, duke më dhembur çdo ditë diku.

E, kur shkoi te mjeku, asgjë nuk del problem!

I kam bërë analizat sa e sa herë dhe çdo gjë e kam mirë, por unë nuk ndihem mirë!

Pse e kam këtë problem?

“Gruaja nga Zvicra”

Përgjigje:

Ti, në fakt, nuk e ke këtë problem sot. Por, kështu ke jetuar që nga fëmijëria...

De fakto, nuk je paciente, por nuk je edhe larg pacientes.

Nuk ke asnjë problem, por ke dhimbje që shkaktohen nga baza nervore psikiatrike, e që rrjedh nga e kaluara traumatike.

Traumatizmi nuk shërohet posa ta kalojë njeriu kufirin e Kosovës.

Brezat tanë jetojnë me trauma dhe kanë nevojë t'i shërojnë traumat. Sepse, bota traumatike vazhdon te çdo kush, madje edhe kur prindi i ka treguar fëmijës diçka nga jeta e vet.

Në rastin tënd nuk bën punë mjekësia, e as jeta klinike, sepse kur je mirë me analizat mjeko-laboratorike, barërat përjashtohen si zgjidhje.

Lufta të mbetët ty, prandaj edhe ka shërim alternativ...



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGIJE